



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
MINISTRI

Nr. 4495 Prot.

Tiranë, më 12.06.2015

UDHËZIM

Nr. 18, datë 12.06.2015

PËR  
DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR. 11/1, DATË 15.04.2015  
“PËR BOTIMIN E TEKSTEVE SHKOLLORE TË REJA  
PËR VITIN SHKOLLOR 2015-2016”

Në mbështetje të neneve 45 dhe 47 të ligjit nr. 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë” dhe të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 107, datë 10.02.2010 “Për botimin, shtypjen, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollore të sistemit arsimor parauniversitar”, i ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Në Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Sportit Nr. 11/1, datë 15.04.2015 “Për botimin e teksteve shkollore të reja për vitin shkollor 2015-2016”, i ndryshuar, afatet kohore të zhvillimit të konkursit, të parashikuara në pikën I, të ndryshojnë si më poshtë:

*“I.3 AFATET KOHORE TË ZHVILLIMIT TË KONKURSIT*

<i>Shpallja e konkurrimit:</i>	<i>20 prill 2015</i>
<i>Dorëzimi i teksteve shkollore:</i>	<i>01 korrik 2015</i>
<i>Shpallja e fituesve:</i>	<i>15 korrik 2015</i>
<i>Përzgjedhja nga mësuesit:</i>	<i>31 korrik – 7 gusht 2015</i>
<i>Shpërndarja dhe shitja e teksteve:</i>	<i>1 shtator - 13 shtator 2015.”</i>

2. Ngarkohen për zbatimin e këtij Udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Arsimit Parauniversitar dhe Komisioni i Vlerësimit të Teksteve në MAS.

*Ky Udhëzim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.*

LINDITA NIKOLLA

  
MINISTËR

